



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I MJEKËSISË TIRANË
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ Prot

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

**OBJEKTI I PROCEDURËS: BLERJE TONERA PËR NJËSITË SHPENZUESE TË
UNIVERSITETIT TË MJEKËSISË, TIRANË**

Blerje tonera për njësitë shpenzuese të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Toner per printer, makina fax, toner per makinat fotokopjuese.

Toner per printer lazer /makina fax- 30125110-5; Toner për makinat fotokopjuese- 30125120-8

VLERA E FONDIT LIMIT: FONDI LIMIT TOTAL : 3,662,944.00 (tre milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e dyzetë e katër) **Lekë pa TVSH,**

Për Fakultetin e Mjekësisë vlere e fondit limit është **1,491,633.33** (një milion katërqind nëntëdhjetë e një mijë e gjashtëqind e tridhjetë e tre pik tridhjetë e tre) **lekë pa t.v.sh.**

Për Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike vlere e fondit limit është **326,833.33** (treqind e njëzetë e gjashtë mijë e tetëqind e tridhjetë e tre pik tridhjetë e tre) **lekë pa t.v.sh**

Për Fakultetin e Mjekësisë Dentare vlere totale vlere e fondit limit është **521,444** (pesëqind e njëzetë e një mijë e katërqind e dyzetë e katër) **lekë pa t.v.sh**

Për Rektoratin e Universitetit të Mjekësisë vlere e fondit limit është **1,323,033.33** (një milion e treqind e njëzetë e tre mijë e tridhjetë e tre pik tridhjetë e tre) **lekë pa t.v.sh**

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Kërkesat e mesiperme janë detyruese dhe i shërbejnë Autoritetit Kontraktor për të krijuar bindjen e tij se operatorët ekonomik pjesëmarrës ushtrojnë veprimtarinë e tyre konform

kerkesave te legjislacionit ne fuqi, permbushin kriteret ligjore per te marre pjese ne procedura prokurimi si dhe kane shlyer te gjitha detyrimet tatimore dhe ato te energjise elektrike sipas percaktimeve te legjislacionit perkates.

Po ashtu, paraqitja e sigurimit te ofertes eshte detyrim ligjor i percaktuar nga legjislacioni ne fuqi mesipercituar, si nje mjet garancie per AK ne rast te tereheqjes se ofertës pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave; refuzimit për nënshkrimin e kontratës së prokurimit apo mosparaqitjes së sigurimit të kontratës, kur oferta është shpallur fituese, ose mosplotësimit të ndonjë kushti tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së percaktuar në dokumentet e tenderit.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për xhiron vjetore për 3 vitet e fundit financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk duhet të jetë më e vogël se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, **në të paktën një vit të periudhës së kërkuar** nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është percaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar si dhe nenin 43, tëVKM nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" të ndryshuar me vendimin Nr. 498, datë 1.8.2024 "*Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 285, datë 19.5.2021, të këshillit të ministrave*."

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Sipas nenit 43, pika 2, gërma b) e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 për të ndryshuar me vendimin Nr. 498, datë 1.8.2024 "*Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 285, datë 19.5.2021, të këshillit të ministrave*" vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar. Vlera e kërkuar është në përpjestim të drejtë me fondin limit të procedurës. Kërkesat e mësipërme i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "*Për tatimin mbi të ardhurat*", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006 "*Për tatimin mbi të ardhurat*", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "*Për deklarinimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike*".

(Shënim:Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi).

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 29, të Ligjit Nr.8438, datë 28.12.1998 "*Për tatimin mbi të ardhurat*", i ndryshuar.

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).

Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” neni 40, pika 4 si dhe neni 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Argumentimi si më lart. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e kërkuar është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme si dhe përvojën e duhur, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi

2.3.2 Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesë Çertifikatë ISO 9001:2015 ose ekuivalente (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë

Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 77 dhe 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", është kërkuar kjo certifikatë me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të cilësisë. Certifikata duhet të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Nisur nga rëndësia, volumi i kontratës, rëndësia e AK (Autoritetit kontraktor) të përfshirë në këtë procedurë është e rëndësishme me qëllim realizimin me sukses të kësaj procedurë që operatori pjesëmarrës të provojnë se ka një sistem të menaxhimit të cilësisë, pra të demonstrojnë aftësinë e tij për të ofruar vazhdimisht produkte që plotësojnë kërkesat e konsumatorëve, pra të AK-së dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullative me qëllim të rrisë kënaqësinë e konsumatorit nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit dhe sigurimin e konformitetit ndaj klientit pra Ak-së .

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë certifikatën ISO 14001:2015 ose ekuivalente, të lëshuar nga nje organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 77 dhe 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar , është kërkuar kjo certifikatë me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të cilësisë. Certifikata duhet të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

ISO 14001:2015 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret të objektit të prokurimit) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

2.3.4 Operatori ekonomik të paraqesë një Deklaratë e cila të përmbajë:

- 1. Tonerat do të jenë origjinale ose ekuivalente, të reja, nuk do të jenë të rimbushura, nuk do të jenë të ricikluara, nuk do të jenë të riprodhuara, do të jenë të paketuara e të pahapura.*
- 2. Tonerat do të përmbajnë pullën e sigurisë së prodhuesit (siç aplikohet nga prodhuesi). Tonerat do të jenë sipas kapaciteteve të kërkuara. Emri i prodhuesit/marka do të jene te pasqyruara ne ambalazh.*
- 3. Kodet e tonerave do të jenë të përshtatshme për rajonin tonë dhe të funksionojnë në pajisje.*

4. Merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit të mallrave të furnizuara në të gjithë adresat e njësive të Autoritetit Kontraktor.

5. Tonerat të kenë afat skadence jo më pak se një vit nga momenti i lëvrimin të mallit, (në momentin e dorëzimit të mallit tek autoritetit kontraktor, malli të shoqërohet me deklaratën e garancisë).

Argumentim: Në bazë të nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se artikujt objekt prokurimi janë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit, të gjithë artikujve.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, neni 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se do të kryejnë transportin e mallrave objekt prokurimi në adresën e autoritetit kontraktor, sa herë të lidhet kontratë ndërmjet palëve kontraktore, brenda afatit të parashikuar të marrëveshjes kuadër.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, neni 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë këtë fakt me qëllim krijimin e sigurisë dhe garancisë për Autoritetin Kontraktor që malli me të cilin do furnizohet ky i fundit, ti përshtatet llojeve dhe pajisjeve të printimit dhe fotokopjimit.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të disponojë 1 (një) mjet për transportin e mallrave objekt prokurimi, i cili mund të jetë në pronësi/qera/huapërdorje.

Për sa më sipër operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë të dhënat për mjetin sipas formatit të mëposhtëm:

| Nr. | Lloji i mjetit | Targa | Statusi |
|-----|----------------|-------|--------------------------|
| 1 | | | Pronesi/qera/huapërdorje |

1. Për mjetin në pronësi/qera/huapërdorje duhet të paraqitet edhe leje qarkullimi, certifikata e kontrollit teknik (e vlefshme), siguracioni i mjetit (e vlefshme).
2. Për mjetin në pronësi duhet të paraqitet certifikata e pronësisë, ndërsa për mjetin e marrë me qera/huapërdorje duhet të paraqitet kontrata noteriale përkatëse e vlefshme.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar me Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin

Nr. 162/2020 "Per prokurimin publik" dhe nenit 40, pika 5/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, Ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 "Për transportet rrugore" (të ndryshuar), Udhëzimi Nr.15, datë 24.7.2007 "Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe çertifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor" me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Nisur nga fakti se objekt i kësaj kontrate janë furnizimi dhe shpërndarja e mallrave objekt prokurimi, automjeti i mësipërme konsiderohet i domosdoshëm pasi duke marrë në konsideratë natyrën dhe kohëzgjatjen e saj dhe vendodhjen e objekteve në të cilat do të kryhen furnizimet, i shërben Autoritetit Kontraktor për t'u bindur me kapacitetet teknike të ofertuesve me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës.

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

2.3.7 OE të disponojë 1 (një) person me profesionin shofer/punëtor i thjeshtë, OE paraqet 1 (një) punonjës që të jetë i regjistruar në listpagesat e shoqërisë si shofer ose punonjës i thjeshtë, por që disponon lejen përkatëse të drejtimit të mjetit dhe mund të realizojë me sukses shërbimin e transportit të mallrave objekt prokurimi brenda afateve të ekzekutimit të kontratës.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar me Ligjin 16/2024 "Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 "Per prokurimin publik" dhe nenit 40, pika 5/ b dhe c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion punonjësit për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Nisur nga fakti se objekt i kësaj kontrate janë furnizimi dhe shpërndarja e mallrave objekt prokurimi, personi do të bëjë shpërndarjen e mallrave me automjetin prandaj konsiderohet i domosdoshëm.

2.3.8 Operatorët ekonomikë në ditën dhe orën e hapjes së ofertave, në ambientet e Rektoratit të UMT-së, duhet të paraqesin mostrat për tonerat e kërkuar për të provuar pajtueshmërinë me specifikimet teknike të vendosura në shtojcën 5.

Mostrat duhet të paraqiten të ambalazuara në kuti të shoqëruara me listën e mostrave të paraqitura. Në secilën mostër duhet të vendoset etiketë me numrin e artikullit të paraqitur me nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik.

Mosparaqitja e mostrave sipas specifikimeve teknike të kërkua është kusht për skualifikimin e operatorit ekonomik.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është kërkuar bazuar në mbështetje të nenit 23 të Ligjit Nr. 162, datë 23.11.2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar me Ligjin 16/2024 "Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 "Per prokurimin publik", neneve 2, në pikën 6 të Nenit 40 dhe 115 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", (në vijim "VKM"), i ndryshuar VENDIM Nr. 498, datë 1.8.2024 "Për disa

shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 285, datë 19.5.2021, të këshillit të ministrave”, sipas së cilës: Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike, Mostrat trajtohen si informacion konfidencial dhe janë në kontroll të autoritetit kontraktor. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit”.

Paraqitja e mostrave i shërben autoritetit/entit kontraktor për të gjykuar më mirë mbi përmbushjen e specifikimeve të kërkuara për objektet që prokurohet, me qëllim që, cilësia e mallit të jetë në përputhje me kërkesat e përcaktuara prej tij. Mostrat e paraqitura do të kontrollohen nëse përmbushin specifikimet teknike të kërkuara, për ti dhënë garanci operatorit ekonomik për përmbushjen me sukses të procedurës objekt prokurimi, në përputhje me kërkesat e paraqitura nga njësitë shpenzuese si dhe për faktin se në shkresat boja nuk duhet të fshihet pasi ruhen për një kohë të gjatë si dhe janë pjesë e kontrolleve auditeve të brendshme dhe të jashtëme.

Mostrat e kërkuara do të dorëzohen në ditën e hapjes së procedurës nga OE pjesmarrës në procedure në orën 10:30 si dhe do të mbahet procesverbal në të cilin do të dokumentohet procesi i paraqitjes së mostrave duke pasqyruar detaje që përshkruajnë mostrën/at e administruara.

II - Ambalazhimi

Mallrat duhet të dorëzohen të ambalazuara si më poshtë:

Tonerat të jenë të mbeshtjella në qese në menyrë hermetike dhe të pahapura (duke plotësuar kushtet e ruajtjes së sigurtë) dhe të ambalazuara nëpër kuti, të shoqëruara këto me pulla sigurie nga prodhuesi. Tonerat duhet të plotësojnë të gjithë elementet e sigurisë dhe do të kryhet kontroll rigoroz për plotësimin e këtyre elementeve.

Duhet të lexohen me vëmendje rregullat e përdorimit dhe përbërësit në etiketën e çdo produkti për t’u mbrojtur nëse ka lëndë të rrezikshme.

Mbi ambalazh të vendoset etiketa me të dhënat e mëposhtme:

- Emri i produktit
- Emri i markës prodhuese
- Pulla e sigurisë
- Specifikimet e kërkuara.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën në çdo kohë të bëjë çdo verifikim për originalitetin e produkteve të ofruar

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Argumentim: Në bazë të nenit të 36, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” nenit 15, pika 3/b dhe nenit 40, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar). Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara si dhe janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” bazuar në regjistrin e parashikimeve të procedurave të prokurimit publik të përqëndruara për vitin 2024 të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë dhe kërkesave të Fakulteteve, përkatësisht shkresës nr. 367 prot., datë 11.06.2024 të F.M.D-së me lëndë “Dërgim i kërkesave të detajuara për fillimin e procedurave të prokurimit”, protokolluar pranë Rektoratit të UMT- së me nr. 25/33, datë 11.06.2024, shkresës nr. 720/2 prot., datë 11.06.2024 të F.SH.MT.-së me lëndë “Dërgohen specifikimet teknike të procedurave të prokurimit të përqëndruara “UMT-së”,

protokolluar pranë Rektoratit të UMT-së me nr. 25/36, datë 12.06.2024, shkresës nr.1678/1 prot., datë 03.06.2024 të F.M.-së me lëndë “Dërgim i kërkesave për nisjen e procedurave të prokurimit të përqendruar pranë UMT-së për Fakultetin e Mjekësisë”, protokolluar pranë Rektoratit të UMT-së me nr.25/30 prot., datë 03.06.2024 si dhe bazuar në nevojat e njesisë Rektorat të UMT-së për vitin 2024:

TABELA:

| Nr | Emërtimi | Nr.Kopjeve | Njësia | SASIA |
|----|--|------------|--------|-------|
| 1 | Toner Toshiba estudio2007/2006 ose ekuivalente | min 10000 | copë | 35 |
| 2 | Toner Toshiba 167/166/ ose ekuivalente | min 2400 | copë | 15 |
| 3 | Toner OKI black 332/MC363/ose ekuivalente | min 3500 | copë | 43 |
| 4 | Toner OKI cyan 332/MC363/ose ekuivalente | min 3000 | copë | 25 |
| 5 | Toner OKI magenta 332/MC363/ose ekuivalente | min 3000 | copë | 25 |
| 6 | Toner OKI yellow 332/MC363/ose ekuivalente | min 3000 | copë | 25 |
| 7 | Toner Xerox Versalink B400/ ose ekuivalente | min 13900 | copë | 6 |
| 8 | Toner per printer Advanced Kryocera F5-2100 / ose ekuivalente | min 10000 | copë | 6 |
| 9 | Tomer Kryocera Multifunctional ECOSYS M5521 cdn black/ose ekuivalente | min 2600 | copë | 12 |
| 10 | Tomer Kryocera Multifunctional ECOSYS M5521 cdn magenta/ose ekuivalente | min 2200 | copë | 12 |
| 11 | Tomer Kryocera Multifunctional ECOSYS M5521 cdn yellow/ose ekuivalente | min 2200 | copë | 12 |
| 12 | Tomer Kryocera Multifunctional ECOSYS M5521 cdn cyan/ose ekuivalente | min 2200 | copë | 12 |
| 13 | Genuine Toner Toshiba e-studio 222cp black/ose ekuivalente | min 3000 | copë | 10 |
| 14 | Genuine Toner Toshiba e-studio 222cp magenta/ose ekuivalente | min 2000 | copë | 7 |
| 15 | Genuine Toner Toshiba e-studio 222cp yellow/ose ekuivalente | min 2000 | copë | 7 |
| 16 | Genuine Toner Toshiba e-studio 222cp cyan/ose ekuivalente | min 2000 | copë | 7 |
| 17 | Genuine Kryocera M2135dn (black) /ose ekuivalente | min 3000 | copë | 5 |
| 18 | Toner OKI B432 / ose ekuivalente | min 12000 | copë | 15 |
| 19 | Toner Lexmark B2338/ ose ekuivalente | min 3000 | copë | 7 |
| 20 | Toner Xerox B1022/ ose ekuivalente | min 13700 | copë | 5 |
| 21 | Toner Toshiba e-studio 520 / ose ekuivalente | min 60000 | copë | 7 |
| 22 | Toner OKI 411/ose ekuivalente | min 3000 | copë | 30 |
| 23 | Toner OKI 412/ose ekuivalente | min 3000 | copë | 46 |
| 24 | Toner Brother HL - L8260CDW Black/ ose ekuivalente | min 6500 | copë | 8 |
| 25 | Toner Brother HL - L8260CDW Cyan/ ose ekuivalente | min 4000 | copë | 8 |
| 26 | Toner Brother HL - L8260CDW Magenta/ ose ekuivalente | min 4000 | copë | 8 |
| 27 | Toner Brother HL - L8260CDW Yellow/ ose ekuivalente | min 4000 | copë | 8 |
| 28 | Toner Canon Black Advance DX 6855i/ose ekuivalente | min 71500 | copë | 6 |
| 29 | Kyocera TASKalfa 2553ci Black/ose ekuivalente | min 20000 | copë | 8 |
| 30 | Kyocera TASKalfa 2553ci Cyan/ose ekuivalente | min 12000 | copë | 8 |
| 31 | Kyocera TASKalfa 2553ci Magenta/ose ekuivalente | min 12000 | copë | 8 |
| 32 | Kyocera TASKalfa 2553ci Yellow/ose ekuivalente | min 12000 | copë | 8 |
| 33 | Toner Xerox Altalink Black B8155/ose ekuivalente | min 52000 | copë | 8 |
| 34 | Genuine Toner Multifuncional b/w MFP basic Xerox B7030/ /ose ekuivalente | min 30000 | copë | 15 |
| 35 | Toner Xerox B 7130 Black | min 34200 | copë | 20 |
| 36 | Genuine Toner Lexmark B2650dw | min 1000 | copë | 15 |
| 37 | Genuine Toner OKI MB 472 / ekuivalente | min 3000 | copë | 10 |
| 38 | Toner Versalink C7120/7125/7130 Black/ose ekuivalente | min 31300 | copë | 13 |
| 39 | Toner Versalink C7120/7125/7130 Cyan/ose ekuivalente | min 18500 | copë | 4 |
| 40 | Toner Versalink C7120/7125/7130 Magenta/ose ekuivalente | min 18500 | copë | 4 |

| | | | | |
|----|--|-----------|------|----|
| 41 | Toner Versalink C7120/7125/7130 Yellow/ose ekuivalente | min 18500 | copë | 4 |
| 42 | Toner Workcenter 3025 | min 1500 | copë | 24 |
| 43 | Toner Xerox C235 (set) (YCM) | min 2500 | set | 11 |
| 44 | Toner Xerox C235 (black) | min 3000 | copë | 25 |

Lista e tonerave në total dhe së bashku me Njësitë shpenzuese të Universitetit të Mjekësisë,Tiranë:

| Nr | Emërtimi | Nr.Kopjeve | Njësia | SASIA REKTORAT | SASIA FM | SASIA FSHMT | SASIA FMD | SASIA TOTAL |
|----|---|------------|--------|----------------|----------|-------------|-----------|-------------|
| 1 | Toner Toshiba estudio2007/2006 ose ekuivalente | min 10000 | copë | | 15 | 20 | | 35 |
| 2 | Toner Toshiba 167/166/ ose ekuivalente | min 2400 | copë | | 15 | | | 15 |
| 3 | Toner OKI black 332/MC363/ose ekuivalente | min 3500 | copë | 5 | 18 | 20 | | 43 |
| 4 | Toner OKI cyan 332/MC363/ose ekuivalente | min 3000 | copë | 5 | 15 | 5 | | 25 |
| 5 | Toner OKI magenta 332/MC363/ose ekuivalente | min 3000 | copë | 5 | 15 | 5 | | 25 |
| 6 | Toner OKI yellow 332/MC363/ose ekuivalente | min 3000 | copë | 5 | 15 | 5 | | 25 |
| 7 | Toner Xerox Versalink B400/ ose ekuivalente | min 13900 | copë | | 6 | | | 6 |
| 8 | Toner per printer Advanced Kryocera F5-2100 / ose ekuivalente | min 10000 | copë | | 6 | | | 6 |
| 9 | Tomer Kryocera Multifunctional ECOSYS M5521 cdn black/ose ekuivalente | min 2600 | copë | | 12 | | | 12 |
| 10 | Tomer Kryocera Multifunctional ECOSYS M5521 cdn magenta/ose ekuivalente | min 2200 | copë | | 12 | | | 12 |
| 11 | Tomer Kryocera Multifunctional ECOSYS M5521 cdn yellow/ose ekuivalente | min 2200 | copë | | 12 | | | 12 |
| 12 | Tomer Kryocera Multifunctional ECOSYS M5521 cdn cyan/ose ekuivalente | min 2200 | copë | | 12 | | | 12 |
| 13 | Genuine Toner Toshiba e-studio 222cp black/ose ekuivalente | min 3000 | copë | 10 | | | | 10 |
| 14 | Genuine Toner Toshiba e-studio 222cp magenta/ose ekuivalente | min 2000 | copë | 7 | | | | 7 |
| 15 | Genuine Toner Toshiba e-studio 222cp yellow/ose ekuivalente | min 2000 | copë | 7 | | | | 7 |
| 16 | Genuine Toner Toshiba e-studio 222cp cyan/ose ekuivalente | min 2000 | copë | 7 | | | | 7 |
| 17 | Genuine Kryocera M2135dn (black) /ose ekuivalente | min 3000 | copë | 5 | | | | 5 |
| 18 | Toner OKI B432 / ose ekuivalente | min 12000 | copë | | 15 | | | 15 |
| 19 | Toner Lexmark B2338/ ose ekuivalente | min 3000 | copë | | 7 | | | 7 |
| 20 | Toner Xerox B1022/ ose ekuivalente | min 13700 | copë | | 5 | | | 5 |
| 21 | Toner Toshiba e-studio 520 / ose ekuivalente | min 60000 | copë | | 7 | | | 7 |
| 22 | Toner OKI 411/ose ekuivalente | min 3000 | copë | | 20 | 10 | | 30 |
| 23 | Toner OKI 412/ose ekuivalente | min 3000 | copë | | 16 | 30 | | 46 |
| 24 | Toner Brother HL - L8260CDW Black/ ose ekuivalente | min 6500 | copë | | 8 | | | 8 |
| 25 | Toner Brother HL - L8260CDW Cyan/ ose ekuivalente | min 4000 | copë | | 8 | | | 8 |
| 26 | Toner Brother HL - L8260CDW Magenta/ ose ekuivalente | min 4000 | copë | | 8 | | | 8 |
| 27 | Toner Brother HL - L8260CDW Yellow/ ose ekuivalente | min 4000 | copë | | 8 | | | 8 |

| | | | | | | | | |
|----|--|-----------|------|----|---|----|----|----|
| 28 | Toner Canon Black Advance DX 6855i/ose ekuivalente | min 71500 | copë | | 6 | | | 6 |
| 29 | Kyocera TASKalfa 2553ci Black/ose ekuivalente | min 20000 | copë | | 8 | | | 8 |
| 30 | Kyocera TASKalfa 2553ci Cyan/ose ekuivalente | min 12000 | copë | | 8 | | | 8 |
| 31 | Kyocera TASKalfa 2553ci Magenta/ose ekuivalente | min 12000 | copë | | 8 | | | 8 |
| 32 | Kyocera TASKalfa 2553ci Yellow/ose ekuivalente | min 12000 | copë | | 8 | | | 8 |
| 33 | Toner Xerox Altalink Black B8155/ose ekuivalente | min 52000 | copë | | 8 | | | 8 |
| 34 | Genuine Toner Multifuncional b/w MFP basic Xerox B7030/ /ose ekuivalente | min 30000 | copë | 15 | | | | 15 |
| 35 | Toner Xerox B 7130 Black | min 34200 | copë | | | | 20 | 20 |
| 36 | Genuine Toner Lexmark B2650dw | min 1000 | copë | 15 | | | | 15 |
| 37 | Genuine Toner OKI MB 472 / ekuivalente | min 3000 | copë | | | 10 | | 10 |
| 38 | Toner Versalink C7120/7125/7130 Black/ose ekuivalente | min 31300 | copë | | | | 13 | 13 |
| 39 | Toner Versalink C7120/7125/7130 Cyan/ose ekuivalente | min 18500 | copë | | | | 4 | 4 |
| 40 | Toner Versalink C7120/7125/7130 Magenta/ose ekuivalente | min 18500 | copë | | | | 4 | 4 |
| 41 | Toner Versalink C7120/7125/7130 Yellow/ose ekuivalente | min 18500 | copë | | | | 4 | 4 |
| 42 | Toner Workcenter 3025 | min 1500 | copë | | | | 24 | 24 |
| 43 | Toner Xerox C235 (set) (YCM) | min 2500 | set | 11 | | | | 11 |
| 44 | Toner Xerox C235 (black) | min 3000 | copë | 25 | | | | 25 |

NJËSIA E PROKURIMIT: